



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gjiçane  
Municipal Gjiçan  
Gilan Belediyesi

## DREJTORIA E ARSIMIT

---

Në bazë të nenit 5 pika c të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 08/2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës-drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria Komunitare e Arsimit në Gjiçan, shpall :

### K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

#### Shkollat fillore të mesme të ulëta

- I- Shkolla fillore “ Lagjja e VIII” në Gjiçan
  - Pozita : Drejtor
- II- Shkolla fillore “ Ramiz Cernica” në Cernicë
  - Pozita : Drejtor
- III-Shkolla fillore “ Vesel Muja” në Mehirë
  - Pozita : Drejtor
- IV- Shkolla fillore “ Skenderbeu” në Përlepnice
  - Pozita : Drejtor
- V-Shkolla fillore “ Vebi Ibrahim” në Uglarë
  - Pozita : Drejtor
- VI- Shkolla fillore “ Afërdita” në Kishnapole
  - Pozita : Drejtor – rishpallje
- VII-Shkolla fillore “ Thimi Mitko” në Gjiçan
  - Pozita : zv.Drejtor
- VIII-Shkolla fillore “ Agim Ramadani” në Zhegër
  - Pozita : zv.Drejtor

#### Shkollat e mesme të larta

- I- Shkolla e mesme teknike “ Mehmet Isai” në Gjiçan
  - Pozita : Drejtor
- II- Shkolla e mesme –gjimnazi, drejtimi i shkencave natyrore
  - Pozita : Drejtor
- III-Shkolla e mesme -gjimnazi “ Zenel Hajdini” në Gjiçan
  - Pozita : zv.Drejtor
- IV- Shkolla e mesme ekonomike “ Marin Barleti” në Gjiçan
  - Pozita : zv.Drejtor

**Përshkrimi i punëve :** Udhëheqë institucionin dhe është përgjegjës për :

- Zbatimin e ligjshmërisë,
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorë e tjerë të arsimit,
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës,
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve,
- Detyrat lidhur me kurrikulumin
- Planifikimin,udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në Institucion,
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe aftëgjatë për aktivitetin e Institucionit,
- Qështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji.

**Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs :**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor ( së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar ) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore,
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedur të licencimit,
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim,
- Të kenë më së paku 3 (tri) vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

**Dokumentet e nevojshme:**

- Certifikata e lindjes,
- Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Portfolion profesionale,
- Letërreferencë nga një institucion publik –kredibil ( si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i shkollës , punëdhënësi paraprak , Institucionet e Arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- Planin zhvëllimor të institucionit edukativo arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar ( së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: arial sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Qertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore,
- Dëshminë se nuk është nën hetime,
- Kopja e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre ( gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Kohëzgjatja e kontratës: sipas udhëzimit administrativ 8/2014 ( 4 vite).

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuarat të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Drejtori  
Nazmi Musa